

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

Ë HËNË DATA 05 QERSHOR 2023

E nderuar, zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kolegu im i opozitës tha se në këtë vend nuk ka demokraci. Që të ketë demokraci, si fillim duhet të kemi një republikë kushtetuese. Që të kemi republikë kushtetuese na kërkohet, po ashtu, ta kthejmë në një republikë parlamentare, sepse të tillë e kemi përcaktuar, por që të kemi republikë parlamentare, duhet të kemi zgjedhje të lira dhe të ndershme. Ky vend nuk është as republikë kushtetuese, as republikë parlamentare, por thjesht një republikë kryeministore, prandaj, më shumë se për çdo gjë tjetër, ka nevojë për një reformë të thellë kushtetuese, që parimi i kontrollit dhe i balancimit të pushtetit të funksionojë në shërbim dhe në interes të qytetarëve. Zgjedhjet e 14 majit treguan qartë se nuk ka zgjedhje të lira dhe të ndershme, por unë kam një thirrje për kolegët e mi të opozitës: duhet t'i shikojmë të vërtetat ashtu siç janë dhe jo siç na pëlqejnë! Këto vite ne kemi shkatërruar vetveten dhe mazhoranca ka shkatërruar sistemin tonë kushtetues, kemi marrë vendime absurde deri dhe idioeske, kemi pasur sherre pa kuptim me njëri-tjetrin, mbyllje dhe mediokritet, që nuk vlejnë as për ne dhe as për shqiptarët. Në qoftë se nuk do të kalojmë vetveten dhe t'ua kthejmë opozitën shqiptarëve, duke krijuar një të djathtë me ide të qarta dhe me njerëz kualitativë, ne nuk jemi duke përmbushur detyrimin tonë. Si opozitë, detyrë të parë kemi garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, prandaj të gjithë si fillim duhet të kërkojmë me një qëndrim të vetëm mbledhjen sa më parë të Komisionit të Reformës Zgjedhore. Ta fillojmë nga reforma zgjedhore, nga sistemi zgjedhor që ka vrarë parlamentarizmin në Shqipëri. Le të shikojmë mundësinë për një sistem proporcional kombëtar me lista të hapura, ku gara dhe qytetarët të vendosin kush do të jenë deputetët dhe jo kryetarët e partive. Ato janë primaret e vërteta. Po ashtu, t'u japim mundësi njerëzve të talentuar, të jashtëzakonshëm, që jetojnë në diasporë, që jo vetëm të votojnë, por edhe të konkurrojnë dhe të bëhen pjesë e qeverisjes dhe e politikës shqiptare. Kualitetet e tyre janë të padiskutueshme dhe mentaliteti i tyre është krejt ndryshe nga ky që diskutojmë ne në Kuvendin e Shqipërisë. E djathta, të nderuar kolegë të opozitës, nuk është pazar, por ide, që vlerësojnë në radhë të parë vlerat, individin, familjen, biznesin dhe pa dyshim edhe besimin.

Të nderuar kolegë të opozitës, po vazhduam kështu, zelli dhe dashuria për udhëheqësin do të na lërë pa shqiptarë. Çështja e dytë, për të cilën dua të flas, ka të bëjë me Kosovën. Të flasim për Kosovën nuk na bën patriotë. Rruga e vetme për ta mbështetur Kosovën nuk është të mbajmë qëndrimet tona sikur flasim për një vend të huaj. Ata janë bashkëkombësit tanë dhe përpara çdo marrëdhënieje tjetër, ata janë të parët. Po ashtu, duhet të koordinojmë veprimtarinë tonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Britaninë e Madhe, me NATO-n dhe me BE-në. Ne, shqiptarët, që jemi vend anëtar i NATO-s, duhet të ndërtojmë boshtin e Aleancës së Atlantikut në Ballkan për të gjitha elementet politike dhe ushtarake. Deklaratat kundër njëri-tjetrit vetëm na bëjnë akoma edhe më absurdë. Dua të flas, gjithashtu, edhe për një çështje të tretë, të cilën po e mbyll me një fjali të vetme. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-ja, partnerët tanë, në mënyrë të vazhdueshme ngrenë shqetësimin për penetrimin dhe influencën e Rusisë dhe Kinës në rajonin e Ballkanit. Është detyrë e këtij Kuvendi të marrë një

iniciativë të përbashkët bipartizane për të analizuar se deri ku shtrihet kjo influencë dhe të mos mjaftohemi vetëm me këndvështrimin sipërfaqësor se ne nuk kemi marrëdhënie të tilla. Ka dhe duhet t'i analizojmë, ka politika që duhet t'i ndërtojmë, ka ligje që duhet t'i miratojmë, për të mos lejuar që bizneset dhe ekonomitë e tyre të penetrojnë në vendin tonë, duke cenuar sigurinë dhe marrëdhëniet tona me partnerët. Faleminderit!